REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURES

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 1382 Prot.

Tiranë, më 24.10.2018

**VENDIM Nr. 222, datë 17.10.2018**

Në mbështetje të *Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", Neni 48*, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr. 10, datë 17.10.2018, pasi shqyrtoi Raportin e gërmimeve arkeologjike në ***"Sektorin 6" të projektit "Topografia Epidamne-Dyrrhachion"*** realizuar nga Instituti i Arkeologjisë, në kuadër ***të projektit "Objekt 6 kate me dy kate nëntokë "Lagjia Nr. 1, Rruga "Epikadeve"***, në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit-subjekti "Rajfi" sh.p.k. paraqitur nga subjekt i licencuar në arkeologji Z. Eduard Shehi,

**VENDOSI:**

1. Krahas sondazhit arkeologjik të realizuar në sheshin e zhvillimit të projektit ***"Objekt 6 kate me dy kate nëntokë "Lagjia Nr. 1, Rruga "Epikadeve"***, në zonën arkeologjike "B" të qytetit të Durrësit, nga Instituti i Arkeologjisë, për qëllime shkencore, të realizohet nga subjekti i licencuar në arkeologji edhe një sondazh tjetër.

2. Subjekti "Rajfi" sh.p.k., duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me subjekt të licencuar në arkeologji, i cili do të kryejë sondazhin arkeologjik, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë subjekt.

3. Investitori duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: *sekretaria.kka@asha.gov.al*
Website: asha.gov.al

Scanned by CamScanner

5. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI

MINISTËR

SEKRETAR I KKA

RUDINA ZOTO

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë
Tel: ++355 04 45 35 855
email: *sekretaria.kka@asha.gov.al*
Website: asha.gov.al

Scanned by CamScanner